



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:155946

Datë: 07.08.2023

Numri i dokumentit: 04562103

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurve F.K., nga Ferizaj dhe R.J. nga Ferizaj, duke vendosur lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND. 104/2023, të datës 28.07.2023, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit – të dëmtuarit F.K., në njërën anë dhe të pandehurit – të dëmtuarit R.J., në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1081/2022, të datës 26.10.2022, secili i pandehur veç e veç për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK), në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP) dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, më datë 07.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr.104/2023, e datës 28.07.2023, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurit – të dëmtuarit F.K., me vendbanim në Rr. “...” në Ferizaj, i lindur me datë ..., me numër personal, në njërën anë dhe të pandehurit - të dëmtuarit R.J., me vendbanim në Rr. “...” në Ferizaj, i lindur me datë, me numër personal, në anën tjetër.
- II. Hudhet** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 1081/2022, e datës 26.10.2022, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit F.K., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së dhe ndaj të pandehurit R.J., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.
- III.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr. 1081/2022, të datës 26.10.2022, e ka akuzuar të pandehurin F.K., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së dhe të pandehurin R.J., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

Më datë 26.07.2023, është mbajtur shqyrtimi fillestar dhe në këtë shqyrtim fillestar bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, palët të cilët e kishin cilësinë edhe të pandehurve edhe të dëmtuarve, kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjykata e ka aprovuar propozimin e palëve dhe bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së, e ka referuar çështjen në ndërmjetësim.

Më datë 28.07.2023 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr. 104/2023, në mes të pandehurit – të dëmtuarit F.K., me vendbanim në Rr. “....” në Ferizaj, i lindur me datë, me numër personal, në njërën anë dhe të pandehurit - të dëmtuarit R.J., me vendbanim në Rr. “....” në Ferizaj, i lindur me datë, me numër personal, në anën tjetër.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim KPP-në dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, dhe kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga të gjitha të lartcekurat, e në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2022:222365, datë 07.08.2023

Zyrtarja ligjore,

Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.